

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT  
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT  
QENDRA E TRANSFERIMIT TE TEKNOLOGJIVE BUJQESORE VLORE

---



100 Vjet Pavarësi

*Nr Prot*

*Vlore me*

**Lenda:** Rezultatet e përmbladhura të projekteve të vitit 2012 dhe propozim projektet për vitin 2013

**Drejtuar** Drejtoria e Shërbimit Këshillimor & Informacionit Bujqësor  
MBUMK TIRANE

Bashkëngjitur ju dërgojmë rezultatet e përmbladhura të projekteve të vitit 2012 dhe propozim projektet për vitin 2013

TITULLARI

Dhimitër Panajoti

## *Rezultatet e permbledhura te projekteve ne 2012*

### **Titulli i Projektit1.“ Teknologji bashkëkohore në pemëtari”**

Drejtuesi Ipokrat Fiku

Kohezgjatja ( Fillim -Perfundim)---Janar 2007 – Dhjetor 2013

Buxheti total lek ( Per vitet sa zgjat projekti) lek 6006000

Buxheti vjetor per 2012 : 700000 lek

#### *Objektivat kryesore*

#### **1.Teknologji dhe teknika në prodhimin e materiaqlit bimor te ullirit.**

##### **Rezultatet kryesore te arritura:**

Në mbështetje të prodhimit të rreth 200.000-300.000 fidanave të ullirit me nebulizim, u realizuan prova që kanë të bëjnë me ndryshime në teknologji dhe efikasitetin ekonomike me synim të realizimit të minimumit të shpenzimeve dhe efikasitetin të lartë ekonomike.Provat u ngritën në serrën e prodhimit të fidanave me nebulizim pranë Q T T B Vlore..

- Moshë me optimale e copave të ullirit për rrënjëzim e copave të ullirit është ajo 1 vjeçare.
- Afati më i mirë për mbjellje është 20-30 Mars. Rrënjëzimi i kultivarit Mixan ka rezultuar 60% dhe K.M Berati 50%.
- Substraktet më të mira të përdorura në studim për rrënjëzim rezultojnë:  
a) me perbërje : 80% dhe + 20 % pleh organik. b) 40% shtufë +40 % dherishte + 20% pleh organik, c) 50 % dherishte +25 % rërë + 12.5% torfë +12.5 pleh organik, d) 80% shtufë +20% pleh organik.
- Dimensionet e qeskave që kanë të bëjnë me vëllimin e dherishtes së përsosur për mbjellje, 3 litër,3.5 litër,5litër) për momentin nuk kanë ndryshime të dukshme në zhvillimin e fidanave.

#### **Objektivi 2. Zbatimi i teknologjive në blloqet intensive (pemë, ulli, agrume).**

##### *Rezultatet kryesore te arritura:*

Teknologjitë janë aplikuar në bazën eksperimentale Shamogjin.Ka të bëjë: a) teknika të krasitjes pas vitit të dytë të mbjelljes në ullishtet superintensive, në atë të lëna me dy degë skeletore.në këtë rast bima paraqet fuqi zhvillimi më të madhe. b) aplikimi i plehimit bashkëshoqëruar me ujitjen, si dhe mbrojtjen fitosanitare në pemëtoret intensive (dardhë, qershi,agrumë)

- Në kulturën e pjeshkës dhe kumbullës ( parcela intensive ) rezultat më të mirë ka dhënë prova ku u zbatuan tre ujitje gjatë sezonit të verës, 1 ujitje në Korrik dhe 2 në Gusht të shoqëruara me 80 dhe 100 gr NPK/bimë.

b) distanca të ndryshme mbjellje në cv. Kalinjot me fidana të prodhuara me nebulizim, provë e realizuar në mbështetje të mbjelljeve me subvencin në qarkun e Vlorës.

- Në bazen eksperimentale u mboll parcela me fidanë të kultivarit Kalinjot me fidana të prodhuara me nebulizim, me distanca 5x5 m,5x6, dhe 6 m ( në tarraca)

Roli i distancave tëmbjelljes është i paevidentueshëm për vitin e parë ( rezultati do të ndiqet në vijim të viteve që vijnë).

Në këtë kuadër u realizua krijimi i 4 fermave “pilot”, me fidana të prodhuar me nebulizim të cv. kalinjot (Q.T.T.B, Dukat, Vezhdanisht, Çepirat, Armen ku ecuria e fidanave të mbjellë është mjaft e mirë.

### **Objektivi 3. Përgatitja e specialistëve dhe fermerëve nga ana teorike praktike me koncepte të reja për menaxhimin e kulturave drufrutore.**

*Rezultatet kryesore të aritura:*

U zhvilluan 21 tema trajnimi në të gjitha rrethet, 10 seminare, 5 demonstrime fushore, 8 ditë fushe, 1 Ëork shop,

### **Objektivi 4. Projekte të kërkimit në fermë.**

*Rezultatet kryesore të aritura:*

U ngritën dhe u ndoqën normalisht 4 projekte të kërkimit në fermë.

.1 Në studimin ndikimi i polenizimit artificial në kultivarin Kallmet konfirmon në mënyrë të padiskutueshme reduktimin e fenomenit të milerandimit, e si pasojë rritjen e rendimentit mbi 20 herë. Rekomandohet :

a. Në vreshtat e mbjellë me cv Kallmet të kryhet në cdo 4-5 rreshta shartimi i një rreshti me cv me të njëjtë kohë lulëzimi.

b. Në mbjelljet e reja me cv Kallmet 25 % e bimëve të mbillet me kultivarë polenizues me të njëjtë kohë lulëzimi (Merlot).

2 Në studimin Ndikimi i ujitjes dhe plehrit në madhësinë e kurorës dhe ngarkesa në fruta në madhësinë e kurorës.

Nga provat e bëra rezultoj se kombinimi më i mirë rezultoi: plehrit me ujitje i shoqëruar me rrallim të frutave në masën 15%.

3 Në studimin Format të ndryshme të rikonstuksionit të ullishteve të degraduara me ane të krasitjes

a) Për ullishtet me moshë 60-70 vjecare bëhet rikonstrukcioni i bimëve duke krasitur në masën 50 % të kurorës.

b) Për ullishtet me moshë shekullore: Rinovim total i bimës duke zbatuar krasitje ripërtëritëse në masën 70% të kurorës

.4 Në studimin Forma më optimale tekniko - ekonomike në ullishtet e reja, tradicionale dhe intensive rezulton se forma polikonike e krasitjes formuese është tipi më i mirë pasi rrit sipërfaqen e ndriçimit të kurorës. si dhe ul koston e vjeljes dhe shkurton kohën e hyrjes në prodhim.

*Aktivitetet kryesore*

Mbështetur në metodikat përkatëse, janë ngritur të gjitha studimet e planifikuara si në bazën eksperimentale ashtu dhe nëpër rrethe,. Janë zhvilluar të gjitha trajnimet e hapura konform planit, seminarët, ditët e fushës, etj

*Mënyra e divulgimit të rezultateve, në dobi të përfituesve-*

Janë realizuar 4 biseda televizive nëpërmjet Ëork shop, demonstrimeve fushore, janë divulguar një pjesë e aktiviteteve. Me përfundimin e studimeve divulgimi i rezultateve do të bëhet nëpërmjet fletëpalosjeve, demonstrimeve fushore, artikujve shkencorë, seminarëve me ekstensionistë dhe fermerë, etj

Drejtuesi projektit

Ipokrat Fiku

Titulli i Projektit **Projekti 2: “Menaxhimi i resurseve gjenetike (pemë frutore, hardhi, ulli dhe agrume) dhe shtimi i materialit bimor”**

Drejtuesi Adhurim Lazaj  
Kohezgjatja ( 2007-2013)  
Buxheti total lekë ( 1485000)  
Buxheti vjetor për 2012 ( 850) në mije lekë  
Objektivat kryesore

**Objektivi I. Eksplorimi dhe grumbullimi resurseve gjenetike në pemë frutore, ulli e hardhi**

*Rezultatet kryesore që janë arritur ( apo parashikohen te arrihen )*

1. Nga eksplorimi i zonës së Skraparit Mallakastrës dhe Beratit nga grupi i specialistëve u identifikuan aksesione të reja në pemët frutore (8), ulli (3) e hardhi.(4). Këto aksesione janë gjetur në kopshte dhe oborre të shtëpive në këto zona. Këto aksesione të gjetura sipas poseduesve të tyre dallohen për prodhim të lartë dhe shije të veçantë, rezistencë ndaj kushteve klimaterike, qëndrueshmëri nga sëmundjeve dhe dëmtuesve. Në këto bimë janë etiketuar për marrjen e materialit në pranverë për shtimin e këtyre aksesioneve.

2. Në koleksionin e pemëve frutore autoktone janë studiuar aksesionet e specieve dardhë e kumbull. Për specien dardhë janë studiuar 14 aksesione dhe 12 aksesione për specien kumbull. Këto aksesione kanë një rëndësi të veçantë pasi janë bërthama e resurseve gjenetike autoktone me rëndësi ekonomike dhe vlera për cilësitë e veçanta të tyre. Disa nga këto aksesione me vlera të veçanta janë: dardha Elbje, dardha Gushti, dardha Dimërore, dardha Bishtje etj. Ndër aksesionet e kumbullës më të rëndësishme janë; Kumbulla Vlonjate, Kumbulla Sheqeri, Kumbulla Tropojane etje.

Ky studim do të vazhdoj dhe vitin e ardhshëm për të përcaktuar aksesionet me cilësitë më të mira.

Në të gjitha parcelat mëmë dhe koleksione si rezultat i kryerjes së gjithë shërbimeve sipas preventivave është arritur që gjendja e tyre të jetë e mirë dhe me më pak probleme.

**Objektivi II. Çertifikimi i materialit bimor të ullirit.**

*Rezultatet kryesore që janë arritur*

1. Në vitin 2012 morën rëndësi ullishtet mëmë .Përveç ullishteve ekzistuese u shtuan ullishte mëmë me parametra të teknologjisë se larte .

Lidhur me këtë zhvillim këto parcela u vunë nën kontroll

- për syrin e palloit
- për verticiliozen
- për turbekulozin

Me një protokoll vjetor u realizuan trajtime sistematike për sëmundje e dëmtues kryesor si tenja e ullirit, syri i palloit, hundëgjati, këpusha (aceria) Kontrolli vizual dhe trajtimet kimike u mbështeten me analiza laboratorike në bashkëpunim me Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve te

U. B. T me të cilin po bëhen përpjekje për të krijuar një protokoll aktivitetesh për parambrojtjen dhe identifikimin e parazitëve.

### **Aktivitetet kryesore**

1. Eksplorimi dhe studimi i resurseve autoktonë të pemëve frutore, ulli, hardhi në zonën e Skraparit, Kuçovë , Mallakaster.
2. Shtimi dhe grumbullimi i materialit autoktonë në fidanishte
3. Studimi i aksesioneve në speciet dardhë dhe kumbull në koleksionin autokton të pemëve frutore
4. Plotësimi i D.Base i të dhënave të aksesioneve në koleksionin autokton te pemëve frutore
5. Zbatimi i teknologjive për mirëmbajtjen e sipërfaqes prej 27.2 ha
6. Kontrolli i parcelave meme te ulliri

### **Menyra e divulgimit te rezultateve, në dobi të përfituesve**

1.Nëpërmjet njohjes nga afër të parcelave demonstrative për probleme të ndryshme nëpërmjet organizimit të “Ditëve të fushës” në Bazën eksperimentale të QTTB-Vlorë, por edhe në ferma model të identifikuara më parë, ku edhe është dhënë asistencë teknike nga specialistët tanë. Në këto ditë jene ftuar të marrin pjesë në këto parcela demonstrative të gjithë përfituesit e mundshëm përfshirë drejtues e specialistë të DRBUMK-ve, si dhe fermerë që kultivojnë sipërfaqe të gjera me kultura drufrutore apo fidanërritës.

2. Janë njohur specialistë, fermerë e fidanërritës me kultivarët më të përshtatshëm, të preferuar nga konsumatori dhe rentabël për prodhuesin, në parcelat e koleksionit të ullirit, hardhisë dhe pemëve frutore bërthamore në bazën (Shamogjin),

Drejtuesi i projektit  
Adhurim Lazaj

**.Titulli i projektit : “Studim, Projektim dhe Modelim ferme ne pemtari “**

**2.Drejtuesi i projektit :** Enver Brahimsulaj

**3.Kohëzgjatja :** Janar – Dhjetor 2012

**4.Buxheti total lekë :** 100.000 ( Njëqindmijë )

**5.Buxheti vjetor :** 100.000 lekë

**6.Objektivat dhe rezultatet kryesore :**

**Objektivi I: Studime të efikasitetit ekonomike në pemtari**

**Rezultatet :** Studimi realizua ne Komunen Novose fshati Trevllazer per cv kaninjt Prodaktiviteti prodhimit të ullishteve të zakonshme dhe intensive për vaj

Ullishtet, janë mbi 50 vjecare dhe 80 % e tyre shtrihen 16 - 25 % pjerrësi. Numri i bimëve është 115-140 rrënjë/ha dhe 90 % e sipërfaqes është mbi ujë. U studiuua produktiviteti i prodhimit : kosto për ha, rrënjë, kg dhe për orë pune. Nga analiza e treguesve rezulton se shpenimet jane mete larta se normativat per punimet mekanike 40 %, krasitja 3 herë, vjelja 5 herë, grumbullimi prodhimit 2 herë.Kosto reduktohet me përdorimin e mjeteve mekanike te përshtatshme per terrenin, përdorimin e mjeteve te thjeshta te krasitjes.dhe vjeljes si krëhra plastik, pneumatik dhe elektrik qe menaxhohen lehtësisht nga, ulja e kurorës deri në 60-70 m<sup>3</sup>, përdorimi shtresave per vjelje të përmasave 8x12 m ose 12x12 m për të reduktuar kohën e punës 2 herë.

**Studimi II Ndikimi i elementeve te teknologjise ne koston e prodhimit te ullirit Koker Madh Berati.**

**Objektivi 1: Studimi i kushteve tekniko ekonomike te ullirit per kripje ne zonen e Beratit..**

**Rezultatet:**

Realizimi koston së prodhimit dhe ndërhyrja për reduktimin e saj është qëllimi i studimit. Në kushtet e kultivimit të këtij varieteti në qarkun e Beratit, nga analiza e treguesve ekonomiko-financiar rezulton se : kosto e prodhimit është 115 lek/kg. Në strukturën e saj 51.5 % e zënë materialet, 31.6 % puna e krahut dhe 16.9 % mekanika. Bie në sy mekanizimi mjaft i kufizuar i punimeve dhe niveli i lartë i punës së krahut, dy faktorë që ndikojnë ndjeshëm në efikasitetin e fermës, pa lënë pas dore përdorimin racional dhe të studiuar të bazës materiale sidomos pesticideve dhe plehrave kimike që zënë rreth 90 % të shpenzimeve të kësaj kategorie. Përmirësimi kushteve për rritjen e nivelit të mekanizimit dhe futjen e mjeteve të thjeshta për krasitjen dhe vjeljen e ullirit do të ishin dy elementë të rëndësishëm të koston ku mund të ndërhyhet. Është provuar që dëmtimi i frutit në këtë rast shkon rreth 7-8 % që justifikohet tërësisht nga rritja e produktivitetit të prodhimit.

**Sstudimi 3:Ndërthurja e elementëve tekniko-ekonomik në projektet e ullirit që subvencionohen**

**Objektivi :** Studimi i ecurise dhe tendences se komponentëve te mbjelljeve te reja.

**Rezultatet ;**

Nga studimi rezulton se gjat vitit 2012 janë mbjellë 1719.9 ha dhe 598592 rrënjë ullinj, nga 120000 ha dhe 4382800 rrënjë të planifikuara sipas studimit. Subvencionet zënë 77 % dhe

investimet nga fermeri 23 %. Krahasuar me vitin 2011 nuk ndryshon raporti në mes subvencionit dhe investimit por sipërfaqja e mbjellë është ulur me 44.4 %. Mbizotëron tipi i ullishteve tradicionale me 250-330 bimë/ha. Kultivarët e vendit zënë 30 % të sipërfaqes së mbjellë nga 71 % që duhet të jetë sipas studimit, ndërsa kultivarët e huaj zënë 70 % të sipërfaqes së mbjellë gjithsej nga 29 % të palnifikuar. Edhe tek kultivarët për tavolinë dhe për vaj, për të dy tipet, rezultoni i njëjti raport. Kosto sipas tipit të ullishteve rritet nga ato tradicionale tek intensivitet me rreth 30 %, por që justifikohet me rritje të prodhimit për shkak të numrit të rrënjëve për ha, kushteve të kultivimit dhe teknologjisë së përdorur.

#### **Studimi IV : Promovimi i vererave te kultivareve autokton të rrushit**

##### **Rezultatet :**

Nga vreshtat me kultivare autoktone te 5 varietete : shesh i zi, shesh i bardhë, kallmet, debinë e bardhë e Permetit dhe vlosh. Eshte prodhuar vere. Per te promovuar cilesine e vererave rreth muajit prill 2013 do te kryhen analizat e përcaktuar dhe neoermet tyre dhe degustimit ne nje dite fushe do te përcaktohen varietetet me te mira. promovimi do te shoqerohet me artikuj divulgativ, nëpërmjet mediave, nëpërmjet internetit, me anë të flet palosjeve dhe në takime me aktorë të interesuar.

##### **7. Aktivitetet kryesore :**

1. Është bashkëpunuar me Shërbimet Këshillimore të qarqeve dhe ekstensionistë, me qëllime bashkëpunimi për realizimin e studimeve, saktësishtë e të dhënave dhe plotësimin e formularëve.
2. Janë grumbulluar dhe përpunuar të dhënat për treguesit e përcaktuar për çdo objekt
3. Nëpërmjet takimeve zonave e rajonale me ekstensioniste e fermerë re temave të trajnimit janë komunikuar të dhëna të pjeshme të studimeve .

##### **8. Mënyra e divulgimit të rezultateve në dobi të përfituesve :**

- Organizimi në qarkun e Beratit i një takimi me fermerë dhe ekstensionistë të zonës , dhe më gjërë, për teknologjinë e kultivimit dhe përpunimit të ullirit për kripje.
- Publikim i rezultateve të studimeve të kryera në organe të ndryshme të shtypit në ndihmë të fermerëve për një zhvillim sa më efektiv të aktivitetit të tyre prodhues.

##### **9. Rreziqet eventuale që parashikohen për mosrealizim të objektivave :**

- Mungesa e informacionit për rezultatet e studimeve që përfshin ky projekt do të perbente nje faktor me pak në orientimin e fermerëve për zhvillimin efikas të aktivitetit të tyre menaxhues të prodhimit.

Drejtue projekti  
Enver Brahimsulaj.

## **Propozim i projektit Nr 1 per vitin 2013.**

Titulli i Projektit Teknologji bashkekohore ne pemtari

Drejtuesi Ipokrat Fiku

Kohezgjatja ( Fillim -Perfundim) Janar 2013 – Dhjetor 2013

Buxheti total lek ( Per vitet sa zgjat projekti)

Buxheti vjetor ---

Objektivat kryesore

### **Obj. 1. Teknologji dhe teknika në prodhimin e materialit bimor të ullirit.**

*Rezultatet kryesore qe do te arrihen*

1. Përcaktimi i moshës më optimale të copave të ullirit për rrënjëzim
2. Përcaktimi i afateve optimale të mbjelljes së copave për rrënjëzim në banko. Përqindja e rrënjëzimit në disa kultivarë autoktonë ulliri.
3. Prodhimi i fidanave të ullirit me nebulizim duke përdorur raporte të ndryshme substrati ushqimor në qeskat e rritjes.
4. Ndikimi i përdorimit të ambalazheve të dimensioneve të ndryshme në rritjen dhe zhvillimin e fidanave të ullirit.

### **Obj.2. Zbatimi i teknologjive në blloqet intensive (pemë, ulli, agrume).**

*Rezultatet kryesore qe do te arrihen*

1. Menaxhimi i kurorës në ullishtet intensive dhe superintensive
2. Aplikimi i teknologjisë më optimale (menaxhimi i tokës, kurorës, parazitëve etj.) në resurset gjenetike (ullishte, pemë frutore, vreshta).
3. Modele tekniko- ekonomike të ullishteve

### **Objektivi 3. Përgatitja e specialistëve dhe fermerëve nga ana teorike praktike me koncepte të reja për menaxhimin e kulturave drufrutore.**

*Rezultatet kryesore qe do te arrihen*

1. Zhvillimi temave të trajnimit, demonstrime dhe ditë fushe me specialistë dhe fermerë.

### **Objektivi 4. Projekte të kërkimit në fermë**

*Rezultatet kryesore qe do te arrihen*

Do te ngrihen 4 projekte të kërkimit në fermë

Aktivitetet kryesore

1. Ngritja e studimeve të planifikuara si në bazën eksperimentale ashtu dhe nëpër rrethe
2. Zhvillim i seminareve dhe temave te trajnimit prane DRBU
3. Demonstrime fushore
4. Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme për problemet e kulturave dru frutore në rrethe.

### **Mënyra e divulgimit të rezultateve, në dobi të perfituesve**



Do të bëhet nëpërmjet fletëpalosjeve, demonstrimeve fushore, artikujve shkencorë, seminareve me ekstensionistë dhe fermerë, etj

**Reziqet eventuale qe parashikohen per mosrealizim te objektivave**

Nuk ka rreziqe për mosrealizime.

Drejtuesi i projektit

Ipokrat Fiku

Propozim projekti per vitin 2013,

Titulli i Projektit : **“Menaxhimi i resurseve gjenetike (pemë frutore, hardhi, ulli dhe agrume) dhe shtimi i materialit bimor**

Drejtuesi Adhurim Lazaj

Kohezgjatja ( Fillim -Perfundim) 2013-2013

Buxheti total lek ( Per vitet sa zgjat projekti)

Buxheti vjetor

Objektivat kryesore

**Objektivi I.Eksplorimi dhe grumbullimi resurseve gjenetike në pemë frutore( qershi, kumbull, dardhe, shege, fiq etj), ulli e hardhi**

Rezultati 1.Grumbullimi i resurseve në pemë frutore ulli e hardhi në zonën e Permetit dhe Gjirokastrës

**Objektivi II Pasurimi i koleksioneve me kultivarë të tjerë autoktonë ( 20 aksesione x 5 bime per cdo aksesion )**

Rezultati 1. Shtimi i aksesioneve dhe mbjellja e tyre në koleksionin e pemëve frutore autoktone

Rezultati 2. Promovimi i vererave me kultivare autokton te rrushit.

Rezultati 3. Plotësimi i data baze me aksesionet e reja të grumbulluara

**Objektivi III Studimi i specieve kumbull e dardhë në koleksionin e pemëve frutore autoktone**

Rezultati 1. Studimi i aksesioneve të mbjella në koleksionin e pemëve frutore autoktone

**Objektivi IV. Kontrolli i materialit bimor.**

Rezultati 1. Hartimi i protokolleve të trajtimeve për ullishtet mëmë

Rezultati 2.Plotesimi i skedave të kultivarëve sipas CPOV

Rezultati 3.Zbatimi i teknologjive në pemtore, ullishta e vreshta.

Rezultati 4.Protokolle trajtimesh për të gjithë materialin bimor( protokolle vizual dhe laboratorik)

Rezultati 5. Testimi i kultivareve autokton sipas CPOV.

**Aktivitetet kryesore**

1. Grumbullimi i materialit per shtim te aksesioneve te të pemëve frutore, ulli, hardhi në zonën e Permetit dhe Gjirokastrës.
2. Shtimi dhe grumbullimi i materialit autoktonë në fidanishte
3. Mbajllja e aksesioneve të reja në koleksionin e pemëve autoktonë
4. Studimi i aksesioneve në speciet dardhë dhe kumbull në koleksionin autokton të pemëve frutore
5. Plotësimi i D.Base i të dhënave të aksesioneve në koleksionin autokton te pemeve frutore
6. Zbatimi i teknologjive për mirëmbajtjen e sipërfaqes prej 27.2 ha
7. Kontrolli i parcelave meme te ullirit
8. Kontroll i materialit bimor te parceleve meme te ullirit ne laborator

**Menyra e divulgimit te rezultateve, ne dobi te perfituesve**

Njohja nga afer e fermerëve nepermjet seminareve te organizuara ,dite fushe ,flete palosje, dhe broshurave.

**Reziqet eventuale qe parashikohen per mos realizim te objektivave**

Nuk ka rreziqe per mos realizime

Me shtimin e sipërfaqes se pemeve frutore autoktone plotesohen tokat e pambjella deri me sot ( studim i pergatitur) dhe kalohet ne fazen e studimit te ketyre koleksioneve..

Drejtuesi i projektit

Adhurim Lazaj

## Titulli i Projektit 3 : **Studim, Projektim dhe Modelim ferme ne pentari**

Drejtuesi Enver Brahimsulaj

Kohezgjatja ( Fillim -Perfundim) Janar – Dhjetor 2013

Buxheti total lek ( Per vitet sa zgjat projekti) -----

Buxheti vjetor-----

Objektivi kryesor : Studime të efincencës ekonomike në pentari

### **Studim : Sistemet e ullishtarisë me efektivitet të kufizuar, aspekte tekniko-eknomike.**

**Rezultati 1:** Shtrirja e ullishtarisë margjinale në raport me ullishte të mbjella gjithsej në rrethin e Vlorës.

Rezultati 2 : Përcaktimi i teknologjive për rritjen e produktivitetit të prodhimit

Rezultati 3: Analiza e kostos së prodhimit

Rezultati 4 : Divulgimi i rezultateve të studimit me qëllim shtrirjen e epërsive të teknologjive të reja që propozohen të futen në këto tipe ullishtesh

### **Studim : Epërsitë e organizimit të prodhuesve bujqësor në ulli e vreshta për rritjen e efincencës së fermës**

Rezultati 1: Evidentimi i përparësive të organizimit të prodhimit bujqësor në kooperativa.

Rezultati 2 : Divulgimi i rezultateve me qëllim përhapjen e kasaj forme organizimi në vendin tonë

### **Studim : Planifikimi dhe ndjekja e kostove të prodhimit në ullishtari e vreshtari**

Rezultati 1 : Studimi kostove në ulli e vreshta

Rezultati 1 : Hartimi i manualit të kostove të prodhimit të këtyre kulturave

### **Studim : Evidentimi efincencës ekonomike te fermave intensive të pentarisë në shkallë vendi**

Rezultati 1 : Shtrirja e fermave intensive të pentarisë në shkallë vendi

Rezultati 2 : Divulgimi i rezultateve të studimit nëpërmjet takimeve zonale dhe kombtare, mediave, internetit etj.

### **Rezultatet kryesore qe do te arrihen ( sipas cdo viti dhe perfundimtare)**

Përcaktimi i strategjive të përshtatshme për të ardhmen e zhvillimit të ullishtarisë margjinale në vendin tonë.

Krijimi i nocioneve më të thella tek fermeri për planifikimin dhe ndjekjen e kostos së prodhimit si faktor i rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të të fermës.

Evidentimi i përparësive të organizimit të prodhuesve bujqësor si një element i ri prodhimi në sektorin e pentarisë për rritjen e konkurshmërisë së produktit brënda dhe jashtë vendit.

### **Aktivitetet kryesore**

1. Studimi i produktivitetit të metodave të ndryshme të krasitjes, vjeljes dhe trajtimeve antiparazitare me mjete të thjeshta mekanike.
2. Analiza e treguesve ekonomiko-financiar dhe përcaktimi i efikasitetit të fermës së ullishtarisë marginale
3. Ditë fushe me ekstensionistë dhe fermerë të qarqeve : Vlorë, Fier, Elbasan, Tiranë dhe Berat për reduktimin e kurorësvjeljes dhe krasitjes me mjete të thjeshta mekanike
4. Skedimi dhe marrja e të dhënave organizative, teknike dhe ekonomiko-financiare te kooperativave bujqësore në pentari, studimi dhe publikimi rezultateve.
5. Evidentimi i kushteve teknike të prodhimit të fidanave të pemëve, ullirit, hardhisë dhe agrumeve dhe paraqitja e rrugëve të përmirësimit.
6. Përgatitja, aprovimi dhe publikimi i manualit të kostove të prodhimit të kulturave drufrutorë e vreshta
7. Skedimi dhe studimi i grup fermave intensive të pentarisë sipas qarqeve

#### **8. Reziqet eventuale qe parashikohen per mos realizim te objektivave**

Nuk ka rreziqe per mos realizime

Drejtues projekti  
Enver Brahimsulaj